



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 21.6.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 21.6.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Nertina Kosova, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues,**

Në zbatim të detyrës së lënë prej jush në përfundim të seancës së datës 12.6.2019, në lidhje me prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, mbi ankimin e Komisionerit Publik për vendimin nr. 43/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nisur nga eksperiencia të mëparshme, në referencë të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, dua së pari të vlerësoj shkallën e lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të subjektit të rivlerësimit në kuptimin e drejtë të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, të pozicionit të Komisionerit Publik në procesin e rivlerësimit, nevojën për rihetimin e disa çështjeve të patrajuara nga ana e Komisionit dhe përpjekjet e konsiderueshme që ka kryer që nga momenti i paraqitjes së ankimit, për të mbledhur prova dhe akte, në formën e kërkuar ligjore, duke kontribuar në këtë mënyrë në efektivitetin e procesit të saj rivlerësues.

Kuptimi i duhur ligjor i procedurës së rivlerësimit në Kolegj, në kushtet kur vendimi i Komisionit është ankimuar nga ana e Komisionerit Publik, ka lejuar subjektin e rivlerësimit që shkaqet e parashtruara në ankim t'i konsiderojë dhe t'i trajtojë në kuadrin e kalimit të barrës së provës, duke kërkuar subjekti vetë çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja, të pahetuara më parë nga Komisioni.

Komisioneri Publik, pasi u njoh me shpjegimet dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 12.6.2019, vlerëson se nga ana formale aktet e paraqitura nga subjekti përmbushin të gjitha kërkesat formale për t'u administruar në cilësinë e provës nga ky trup gjykues.

Në referencë të përmbajtjes së tyre dhe nivelit të provueshmërisë në lidhje me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se:

**I.** Lidhur me shkakun e ankimit, që ka të bëjë me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1.000.000 lekë, që ka shërbyer për krijimin e pasurisë apartament 120 m<sup>2</sup>, rr. "\*\*\*\*.\*\*\*", Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e paraqitura në seancën e datës 12.6.2019, ka argumentuar se pretendimet e Komisionerit Publik

gjejnë përgjigje të qartë në rezultatet e hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni, në mbështetje të të cilave Komisioni argumenton se: “...Subjekti i rivlerësimit, N. Kosova, ka pasur mundësi për të krijuar të ardhura në vlerën 1.000.000 lekë apo 1.500.000 lekë dhe diferenca e mundshme për kursim ka qenë në vlerën 2.404.681 lekë deri në fund të vitit 2003<sup>1</sup>”.

Në vijim të shpjegimeve të saj, subjekti ka argumentuar se “...nuk e ka konsideruar babanë si person të lidhur apo person tjetër të lidhur në momentin e deklaramentit “Vetting” dhe nuk kam pasur arsye sipas parashikimeve të nenit 3, pika 13 dhe 14, dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të paraqes dokumente justifikuese për vërtetësinë e deklaramenteve, por pikërisht në momentin që më është kërkuar nga Komisioni, kam dhënë shpjegimet përkatëse... Gjithçka ka rrjedhur nga pagat e mia, që, në mënyrë të ndershme e të pastër, janë administruar nga prindërit e mi, brenda mundësive të mia të kursimit... Nga ana tjetër, është fakt që unë nuk kam deklaruar gjendje “cash” në këto vite, për shkak se, siç kam deklaruar, këto para janë administruar dhe kursyer nga prindërit e mi, por edhe sepse kam bërë një jetë të thjeshtë, në përputhje edhe me standardin e të qenit gjyqtar me integritet dhe duke shmangur maksimalisht çdo lloj konflikti interesi”.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuara nga Komisioneri Publik, për këtë shkak ankimi ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit që të administrohen në cilësinë e provës aktet e numëruara nga 1-9, në: *legjenda e provave*, vënë në dispozicion në seancën e datës 12.6.2019.

*Lidhur me përmbajtjen e tyre*, Komisioneri Publik vlerëson se provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, në një pjesë të tyre (nr. 3,4,5,9 të legjendës) gjenden të administruara në dosjen e Komisionit. Ndërkohë, akte të tjera (nr.1,2,6,7,8) mes të cilave ato që lidhen me përfitimin e bursës gjatë studimeve në Universitetin e Bolonjës, të cilat janë riparazituar në këtë gjykim, sipas kërkesave procedurale, në formën e kopjeve të noterizuara nga noteri publik italian, me vulë apostile të autoritetit përkatës italian, janë akte të reja.

Në vlerësim të Komisionerit Publik, në zbatim të orientimit të dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në prgr. 39 të vendimit (JR) nr. 7/2019, ku: “...orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos konsiderojë si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale, ku ata kanë qenë pjesëmarrës, si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike...”, rezulton se Komisioni, në vendimin nr. 43/2018, argumenton qëndrimin e tij nisur nga një analizë mbi aftësinë financiare të subjektit për vlerën 1.000.000 lekë (f.10 e vendimit), konkretisht në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës 1.000.000 lekë apo 1.500.000 lekë, çështje e trajtuar dhe në prgr. 1.5, të rezultateve të hetimit.

Komisioneri Publik, nisur nga rrethanat e çështjes konkrete të rivlerësimit, akteve të administruara në hetimin administrativ dhe qëndrimin të subjektit në lidhje me mënyrën e

---

<sup>1</sup> Referohuni f. 5 të shpjegimeve të subjektit, të datës 12.6.2019.

administrimit të të ardhurave të krijuar prej saj në vitet kur jetonte me familjen e saj, është i mendimit se hetimi i Komisionit në këtë rast nuk ka qenë orientuar në interpretim të drejtë të ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik çmon se për efekt të nevojës së hetimit të këtij shkakui të ankimit, z. \*\*\*,\*\*\*, duhet të kualifikohet person tjetër i lidhur, në cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes, sipas gjendjes familjare së subjektit të rivlerësimit, të deklaruar ndër vite nga vetë subjekti dhe vërtetuar nga aktet e gjendjes civile.

Analizimi i burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, përfshirë të ardhurat e subjektit, të kryefamiljarit, z. \*\*\*,\*\*\*, për periudhën 1998 - shtator 2006, do të bëjë të mundur verifikimin e origjinës dhe ligjshmërisë së vlerës prej 1.000.000 lekësh, të përdorur nga ana e subjektit për pagesën e çmimit të kontratës së sipërmarrjes së shtatorit 2006.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji *kualifikimin* si person tjetër të lidhur të atit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit dhe hetimin mbi mundësinë e realizimit me të ardhura të ligjshme të shumës 1.000.000 lekë, nga regjimi i ekonomisë së përbashkët familjare.

**II. Lidhur me shkakun e ankimit mbi nevojën në përcaktimin drejt të gjendjes së fakteve që kanë lidhje me kontrollin dhe ligjshmërinë lidhur me lëvizjet bankare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*,\*\*\*, trajtuar në prgr.17.5 të ankimit, të paraqitur nga Komisioneri Publik**

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuar nga Komisioneri Publik, ndër të tjera, ka sqaruar se kjo *transfertë është kryer për llogari të shoqërisë “\*\*\*,\*\*\*”sh.p.k.* Subjekti, për të provuar faktin se i vëllai ka vepruar si përfaqësues dhe mbi bazën e një autorizimi nga shoqëria “\*\*\*,\*\*\*”sh.p.k., duke kryer veprime të ndryshme me vlera financiare për llogari të kësaj shoqërie, ka paraqitur dhe ka kërkuar të administrohen në cilësinë e provës aktet e numërtuara nga 10-48, në: *legjenda e provave*, pjesë e akteve të vëna në dispozicion nga subjekti në seancën e datës 12.6.2019.

Lidhur me përmbajtjen e tyre, Komisioneri Publik vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti përmbushin nevojat për hetim mbi transfertën e kryer nga i vëllai dhe, ndër të tjera, provojnë faktin se: (i) shoqëria “\*\*\*,\*\*\*” sh.p.k. është në marrëdhënie tregtare me shoqërinë “\*\*\*,\*\*\*” l.t.d, si dhe ka kryer transfertat të konsiderueshme me këtë shoqëri; (ii) shtetasi \*\*\*,\*\*\*, për vite me radhë, në emër dhe me autorizim të shoqërisë, ka nënshkruar fatura tatimore shitje, fletëhyrje, mandat-arketime, për llogari të shoqërisë “\*\*\*,\*\*\*”.<sup>2</sup> Sa më sipër, këto prova janë të mjaftueshme në vlerësimin e Komisionerit Publik për të konsideruar të plotë hetimin e këtij shkakui të ankimit.

<sup>2</sup> Subjekti, në përmbushje të nevojave për hetim, ndër të tjera, ka paraqitur dhe ka kërkuar të merren në cilësinë e provës dhe: (1) Deklaratë noteriale nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol, datë \*\*\*.4.2019, e shtetasit \*\*\*,\*\*\*, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*,\*\*\*” sh.p.k., në të cilën ai deklaroi se transaksioni në vlerën 22.350 USD, nga vëllai i subjektit, është kryer për llogari të kësaj shoqërie; (2) Deklaratë noteriale nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2019 e shtetasit \*\*\*,\*\*\* sh.p.k., në të cilën ai deklaroi se transaksioni në vlerën 22.350 USD, nga vëllai i subjektit është kryer për llogari të shoqërisë “\*\*\*,\*\*\*” sh.p.k.

**III.** Lidhur me shkakun e ankimit *huaja e marrë nga i ati i subjektit, z.\*\*\*.\*\*\*, ndaj shtetasit z.\*\*\*.\*\*\**, trajtuar në prgr. A.2 të ankimit, të paraqitur nga Komisioneri Publik

Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se i ati i subjektit të rivlerësimit, me anë të kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2011, ka marrë hua pa interes shumë 7.000.000 lekë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*., me afat shlyerje datë \*\*\*.7.2021. Huaja është marrë në dy pjesë, ku paraprakisht janë dhënë *cash* 3.000.000 lekë dhe 4.000.000 lekë janë kaluar nëpërmjet transfertës bankare në datën e lidhjes së kontratës, datë 8.7.2011.

Komisioneri Publik, në konsideratë të vlerësimit tërësor të çështjes, ndër të tjera, nisur nga fakti se: (i) subjekti nga aktet e administruara rezulton se *deri në maj të 2011* ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit dhe vëllain e saj; (ii) mbetet e paqartë koha e marrjes së diferencës së shumës të dhënë *cash*; (iii) kushtet e parashikuara në këtë kontratë huaje paraqiten të natyrës atipike, pasi kjo shumë e konsiderueshme i jepet hua pa interes një personi me mundësi financiare të kufizuara për ta shlyer, ka çmuar se kjo marrëdhënie huaje duhej të ishte parë si marrëdhënie pasurore e personit tjetër të lidhur, dhe si e tillë t'i nënshtrohej verifikimit të ligjshmërisë së burimit të saj.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuara nga Komisioneri Publik, ndër të tjera, në seancën e datës 12.6.2019, ka sqaruar se: “*Sa i përket kohës së kalimit të shumës prej 7.000.000 lekë nga huadhënësi \*\*\*.\*\*\* te babi im, siç vërtetohet nga transfertat bankare në \*\*\* Bank, 4.000.000 lekë kanë kaluar në datën 8.7.2011, ndërsa shuma e dhënë paraprakisht sipas përcaktimit kontraktor është dhënë po në të atë datë, 8.7.2011. Për të vërtetuar këtë fakt, pra datën e saktë të dhënies së kësaj shume, po paraqes deklaratën noteriale të z.\*\*\*.\*\*\* dhe babait tim, të cilët deklarojnë se këtë shumë huadhënësi \*\*\*.\*\*\* ia ka dhënë babait në datë 8.7.2011, pra ditën e lidhjes së kontratës së huas*”. Subjekti ka kërkuar të administrohet në cilësinë e provës dhe *Deklaratë noteriale nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2019*.

Nisur nga parashtrimet e subjektit në seancën e datës 12.6.2019, aktet e paraqitura në cilësinë e provës, të analizuara, janë në harmoni me aktet e tjera të administruara në dosje. Lidhur me përmbajtjen e deklaratës noteriale, Komisioneri Publik çmon se plotëson nevojat për hetim, të kërkuara në funksion të verifikimit të kohës së marrjes së diferencës së shumës *cash*, si dhe përcaktimit nëse kjo hua do të trajtohet ose jo si e marrë nga personi tjetër i lidhur, në kuptim të cilësimit që i jep personit të lidhur ligji nr. 84/2016.

**IV.** Lidhur me shkakun e ankimit *Likuiditete të padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të*, trajtuar në prgr. A. 3 të ankimit të Komisionerit Publik

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim, të kërkuara nga Komisioneri Publik, ndër të tjera, në seancën e datës 12.6.2019, ka sqaruar se *likuiditetet në formë depozita kursimi apo investimet në bono thesari janë krijuar nga të ardhurat e përfituara nga pagat*.

Komisioneri Publik, për sa është parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, në seksionin: “Deklarimi i interesave private, pasuritë e luajtshme, pasuritë e paluajtshme”, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë të gjitha llojet e pasurive të luajtshme/paluajtshme, si dhe ndryshimet e ndodhura në to, përfshirë

gjendjen e likuiditeteve në llogari bankare apo *cash*, llogaritë rrjedhëse, llogaritë në depozitë, llogaritë në bono thesari, detyrimet dhe të drejtat reale mbi to.

Në këto kushte ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar depozitën dyemërore të përbashkët me të atin, për vitet 2004 në shumën 300.000 lekë, 2005 në shumën 412.712 lekë dhe për vitin 2006 në shumën 303,795 lekë.

Subjekti nuk ka deklaruar kursimet/investimet në bono thesari në vitet 2008, 2009 dhe 2010, në shumat përkatëse 300,000 lekë, 500,000 lekë dhe 700,000 lekë, si dhe ndryshimet e gjendjes në fund të vitit, në llogarinë rrjedhëse pranë \*\*\* Bank.

Komisioneri Publik vlerëson të konstatojë se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me ekzistencën e së njëjtës shumë që ka qarkulluar në sistemin bankar, në banka të ndryshme për periudha të ndryshme kohore, janë të plota dhe kjo rrethanë provohet edhe nga aktet bankare të paraqitura. Komisioneri Publik nënvizon se pasqyrimi i këtyre shumave në ankim, në vlerën e tyre vit pas viti, nuk ka nënkuptuar ekzistencën e një shume kumulative.

**V. Lidhur me shkakun e ankimit, *Çështje të tjera*, trajtuar në prgr. 22 të ankimit, të paraqitur nga Komisioneri Publik**

Për sa i përket mjetit me targë \*\*\*, blerë nga i ati i subjektit në vitin 2000, në vlerën 880.000 lekë, në fashikullin e DPSHTRR-së, në dosje të Komisionit, ndër të tjera, gjenden të administruara:

- (i) Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018, e AMF-së, përmes së cilës konfirmohet se: *“Për Nertina.\*\*\*. Kosova dhe \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*,..... shoqëria ka lëshuar policat TPL me numër serial \*\*\*, periudhë \*\*\*.4.20017 deri \*\*\*.4.2008, targë \*\*\* dhe policën me numër serial \*\*\* periudhë \*\*\*.4.2008 deri \*\*\*.4.2009 targë \*\*\*”.*
- (ii) Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2018 e DRSHTRR-së Elbasan, në të cilën, ndër të tjera, citohet se: *“...ju informojmë se Nertina \*\*\*.Kosova ka pasur në pronësi mjetin me targë \*\*\*, i cili ka dalë nga qarkullimi në datë \*\*\*.7.2010 dhe dosja e tij ndodhet në arkivin qendror të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës. I kemi bërë kërkesën kësaj drejtorie për të na dërguar dosjen dhe më pas t'ju dërgojmë fotokopjen e njësuar me origjinalin”.*
- (iii) Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2018, e DRSHTRR-së Elbasan, në të cilën citohet se: *“...po ju dërgojmë fotokopje të njësuar me origjinalin të dosjes së mjetit me targë \*\*\*, i cili ka qenë në pronësi të shtetases Nertina \*\*\*.Kosova dhe është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datë \*\*\*.7.20101, për arsye amortizimi”.*
- (iv) Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2018, e DPSHTRR-së Elbasan, në të cilën, ndër të tjera, citohet se: *“...Shtetasi \*\*\*.\*\*\*.\*\*\* ka pasur në pronësi mjetin me targë \*\*\*, e cila në datë \*\*\*.7.2010 është hequr nga qarkullimi për arsye amortizimi...”.*

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuara nga Komisioneri Publik<sup>3</sup>, mbi arsyet e mosdeklarimit të mjetit me targë \*\*\*, ka bashkëlidhur shpjegimeve të datës

---

<sup>3</sup> Subjekti në shpjegimet e datës 12.6.2019 pretendon se nuk e ka pasur detyrimin të deklarojë sipas ligjit, por në kuadër të bashkëpunimit sipas nenit 48, të ligjit nr.,84/2016, ka sqaruar në lidhje me shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik.

12.06.2019, si dhe ndër të tjera ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, që të administrohen në cilësinë e provës, aktet si më poshtë<sup>4</sup>:

1. *Kërkesë drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, datë \*\*\*.1.2019, nga subjekti i rivlerësimit;*
2. *Kthim përgjigje nga AMF-ja drejtuar subjektit të rivlerësimit, për dijeni KPK-së, me lëndë: “Konfirmim për mbulimin me sigurim”, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2019;*
3. *Kthim përgjigje nga \*\*\* sh.a., drejtuar subjektit të rivlerësimit, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2019.*

Lidhur me përmbajtjen e tyre, Komisioneri Publik vlerëson se aktet e sipërcituara, përmes së cilave nga ana e AMF-së është saktësuar se nga policat e sigurimit TPL me numër serial \*\*\*, periudhë sigurimi \*\*\*.4.20017 deri \*\*\*.4.2008 dhe policat TPL me numër serial \*\*\* periudhë \*\*\*.4.2008 deri \*\*\*.4.2009 për mjetin me \*\*\* targë, rezultoi i siguar vetëm z. \*\*\*, \*\*\*, si dhe shkresa përmes së cilës shoqëria \*\*\* ka konfirmuar se policat janë lëshuar për mjetin \*\*\*, me të siguar z. \*\*\*, \*\*\*, janë akte të cilat i shërbejnë hetimit administrativ dhe shërbejnë për verifikimin e situatës juridike të pahetuar, nisur nga përmbajtja e akteve në dosje të Komisionit, në lidhje me pronësi të mundshme të automjeteve të padeklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim, të kërkuara nga Komisioneri Publik, mbi mundësitë financiare të të atit të subjektit, si person i lidhur<sup>5</sup>, për të investuar në blerjen e automjetit, ka bashkëlidhur shpjegimeve të datës 12.6.2019, si dhe ndër të tjera ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit që të administrohen në cilësinë e provës, aktet si më poshtë:

1. *Akt-marrëveshje për premtim shitblerje toke bujqësore nr.\*\*\* regj., datë \*\*\*.6.1999;*
2. *Vërtetime të Këshillit të Rrethit Elbasan, datë \*\*\*.6.1999, në emër të \*\*\* e \*\*\*.\*\*\*;*
3. *Akti i marrjes së tokës në pronësi, në emër të \*\*\*.\*\*\* e \*\*\*.\*\*\*;*
4. *Kërkesë Këshillit të Qarkut, datë \*\*\*.5.2016;*
5. *Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2016, e Këshillit të Qarkut Elbasan;*
6. *Autorizim, datë \*\*\*.5.1993, i Këshillit të Rrethit Elbasan;*
7. *Relacion dhe kërkesë, datë \*\*\*.7.1993.*

Lidhur me përmbajtjen e tyre, Komisioneri Publik konstaton se përmes: (i) akt-marrëveshjes për premtim shitblerje nr.\*\*\*, datë \*\*\*.6.1999, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, si dhe shtetasi \*\*\*, \*\*\*, i ati i subjektit të rivlerësimit, kanë në pronësi një sipërfaqe toke bujqësore prej 3000 m<sup>2</sup> që premtojnë t'ia shesin secili pjesën e tij shtetasit \*\*\*, \*\*\*, për shumën e parave 850.000 lekë. Për garantimin e kësaj akt-marrëveshje, z.\*\*\*, \*\*\*, ditën e sotme i jep secilit nga premtuesit si shitës shumën e parave prej 850.000 lekë të reja, në formë kapari. Jashtë kësaj zyre, z.\*\*\*, \*\*\*, dhe z.\*\*\*, \*\*\*, deklarojnë se morën shumën e parave prej 850.000 lekë, si garanci për realizimin e kësaj marrëveshje në formë kapari.

Aktet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë karakter informues mbi pronësinë e shtetasve mbi truallin e fituar sipas AMTP-së përkatëse.

Sa më sipër, këto prova janë të mjaftueshme në vlerësimin e Komisionerit Publik për të konsideruar të plotë hetimin e këtij shkaku të ankimit.

<sup>4</sup> Referohuni f. 24 dhe në vijim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit të datës 12.6.2019.

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj të datës 12.6.2019, ngre pretendimin se i ati i subjektit nuk kualifikohet si person i lidhur/tjetër i lidhur me të.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim, të kërkuara nga Komisioneri Publik, *mbi mungesën e hetimit mbi faktin nëse i vëllai i subjektit ka në pronësi apo përdorim mjete*, ka bashkëlidhur shpjegimeve të datës 12.6.2019, si dhe ndër të tjera ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit që të administrohet në cilësinë e provës, akti si më poshtë:

*1. Vërtetim nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale Elbasan, datë \*\*.10.2016, sipas të cilit shtetasi \*\*.\*\*, i datëlindjes \*\*.12.1978...nuk ka të regjistruar mjete në pronësi.*

*Sa më sipër, këto prova janë të mjaftueshme në vlerësimin e Komisionerit Publik për të konsideruar të plotë hetimin e këtij shkak të ankimit.*

## **Konkluzion**

Nga sa u parashtrua më lart, Komisioneri Publik kërkon nga ky trup gjykues:

1. Administrimin e provave të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të hetimit në Kolegj të shkaqeve të ankimit.

2. Kualifikimin si person tjetër i lidhur të z. \*\*.\*\*, në cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes, sipas gjendjes familjare të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar ndër vite nga vetë subjekti dhe vërtetuar nga aktet e gjendjes civile.

2.1 Analizimi i burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, përfshirë të ardhurat e subjektit, të kryefamiljarit, z \*\*.\*\*, për periudhën 1998 - shtator 2006, për verifikimin e burimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave në vlerën prej 1.000.000 lekësh.

**KOMISIONERI PUBLIK**  
**Florian BALLHYSA**